




REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVO
 AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. DPKI
 Nr. Prot. 06-1811/20
 Nr. I faq. 02
 Data 02-09-2020



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
 ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1, nenit 5, paragrafi 1 pika 1.5, nenit 18, paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores nr. 01/2018 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë Kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 02.09.2020, mori këtë:

V E N D I M

- I. Mbyllet rasti me nr. AKK-DPKI-06-1175/20, për zyrtarin e lartë z. Florit Hoxha, Dekan i Fakultetit të Arkitekturës, Dizajnit dhe Teknologjisë së Drurit, Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, për shkak së është shmangur gjendja e papajtueshmërisë, përkatësisht konfliktit të interesit në ushtrim të funksionit publik.
- II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë në rast se paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Agjencia kundër Korrupsionit (në tekstin e mëtutjeshëm: Agjencia) ka shqyrtuar rastin për konflikt të interesit me numër protokolli AKK-DPKI-06-1175/20, lidhur me zyrtarin e lartë z. Florit Hoxha, Dekan i Fakultetit të Arkitekturës, Dizajnit dhe Teknologjisë së Drurit, Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, duke zhvilluar procedurën e paraparë sipas Ligjit nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Agjencia, sipas detyrës zyrtare ka identifikuar rastin e konfliktit të interesit, sipas të cilit z. Florit Hoxha, krahas ushtrimit të funksionit si zyrtar i lartë publik, respektivisht Dekan i Fakultetit të Arkitekturës, Dizajnit dhe Teknologjisë së Drurit, Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, i njëjti mbante funksionin e Sekretarit dhe Përfaqësuesit të Autorizuar në Organizatën jo-qeveritare "GreenSoul". Përmes shkresës zyrtare nr. DPKI-06-515/20, Agjencia fillimisht ka kërkuar nga Departamenti për OJQ, Ministria e Administratës Publike, verifikimin dhe konfirmimin e këtij informacioni dhe nga përgjigja zyrtare (shkresa zyrtare nr. DPKI-06-776/20), zyrtari i lartë z. Florit Hoxha figuron të jetë Sekretar dhe Person i Autorizuar në OJQ-në në fjalë.

Me rastin e konfirmimit të informacionit të mësipërm, në pajtim me nenin 22, paragrafin 3 dhe 5 të Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, Agjencia përmes shkresës zyrtare AKK-DPKI-06-1173/20 e ka njoftuar zyrtarin e lartë z. Florit Hoxha për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit.



Pas pranimit të kësaj shkrese, pala ka kontaktuar zyrtarin përgjegjës të Agjencisë i cili e ka njoftuar atë gjerësisht lidhur me rastin në fjalë, duke i sqaruar se gjatë ushtrimit të funksionit publik, në cilësinë e zyrtarit të lartë publik, ai nuk mundet që njëkohësisht të mbajë funksion drejtues e as të jetë përfaqësues i autorizuar në OJQ, sepse kjo situatë paraqet gjendje të papajtueshmërisë me ushtrimin e funksionit publik, siç përcaktohet me nenin 13, paragrafi 1, të Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, ku thuhet se:

“Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi menaxhues apo mbikëqyrës i personave juridikë privatë, fitimprurës sipas ligjit përkatës për shoqëritë tregtare dhe organizatave joqeveritare, përjashtuar subjektet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji, subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet me ligj për shkak të funksionit”.

si dhe nenin 14 paragrafi 1, i cili përcakton se:

“Zyrtari i lartë mund të jetë anëtar i organit drejtues, me përjashtim të funksionit drejtues, të organizatës joqeveritare nga lëmi i shkencës, sportit, arsimit, kulturës, veprimtarive humanitare dhe të ngjashme pa të drejtë shpërblimi me pagesë, përveç të drejtës në kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe të tjera të lidhura me to”.

Pas diskutimit dhe ballafaqimit të fakteve, zyrtari i lartë z. Florit Hoxha është pajtuar me gjetjet e Agjencisë, duke deklaruar se do të ndërmarr veprime të menjëhershme dhe konkrete në mënyrë që të shmang papajtueshmërinë në ushtrimin e funksionit publik.

Në ndërkohë, pala ka njoftuar Agjencinë se ka filluar procedurën për shuarjen e OJQ-së në fjalë dhe sapo të jetë nxjerrë vendimi për shuarjen e saj, të njëjtin do t’ia përcjell Agjencisë për veprime të mëtejshme.

Më pas, Agjencia ka pranuar vendimin (shkresa zyrtare DPKI-06-1323-1/20), ku dëshmohet se zyrtari i lartë z. Florit Hoxha ka bërë ndryshimin e të dhënave, përkatësisht shuarjen e Organizatës joqeveritare “GreenSoul”, me nr. të regjistrimit 5102135-5, dhe rrjedhimisht i njëjti nuk figuron më të jetë Sekretar e as Person i Autorizuar në OJQ-në në fjalë.

Me veprimet e ndërmarra nga zyrtari i lartë z. Florit Hoxha, Dekan i Fakultetit të Arkitekturës, Dizajnit dhe Teknologjisë së Drurit, Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, janë krijuar rrethana të reja me çfarë është shmangur gjendja e papajtueshmërisë, përkatësisht konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë. Prandaj, në bazë të asaj që u tha më sipër, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18, paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik,
- Drejtorit të DPKI-së,
- Zyrtarit përgjegjës.

Shaip Havolli
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit